

PROCESVERBAL
nga seanca e 19-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime
Mediatike Audio dhe Audiovizuale
mbajtur më 21.5.2026

Anëtarët e Këshillit të Agjencisë: mr. Sasho Stefanovski, mr. Zirjeta Jajaga, mr. Gordana Majnova, Afrona Vërzivolli, Cvetanka Minovska dhe Viktor Pavlovski.

Anëtarët në mungesë të Këshillit të Agjencisë: Petar Xhurovski (pushim vjetor).

Në seancë ishte i pranishëm dhe dr. Zoran Trajčevski, drejtor i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale.

Të pranishëm nga shërbimi profesional: mr. Ivona Mufisheva, Goran Radunović, Jeton Ismaili, mr. Ruzhica Boshnakoska Jotevska, Sergej Todorovski.

Të pranishmit e tjerë: /

Kryetari i Këshillit, mr. Sasho Stefanovski, hapi seancën e 19-të të Këshillit. Seanca filloi në orën 12:00 dhe u mbajt nëpërmjet lidhjes video-konferencë.

Këshilli i Agjencisë njëzëri, me 6 vota "pro", miratoi si vijon:

RENDIN E DITËS

1. Miratimi i Propozim-procesverbalit nga seanca e 18-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, të mbajtur më 20.5.2026.
2. Propozim për rritjen e Planit Financiar të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale për vitin 2026, me propozim-vendim.
3. Të ndryshme.

Pika 1

Këshilli shqyrtoi dhe njëzëri miratoi Procesverbalin e propozuar nga seanca e 18-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, të mbajtur më 20.5.2026, me tekstin e propozuar.

Pika 2

Drejtori i Agjencisë, dr. Zoran Trajčevski, shpjegoi propozimin për rritjen e Planit Financiar të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale për vitin 2026. Ai shpjegoi se ka problem me funksionimin e dy ashensorëve kryesorë në selinë e Agjencisë, dhe firma e zgjedhur në thirrjen publike nuk është në gjendje t'i servisojë. Prandaj, është rënë dakord me firmën e mëparshme që mirëmbante ashensorët të ndërpritet kontrata me marrëveshje të ndërsjellë, me qëllim që të shpallet furnizim i ri publik dhe të zgjidhet operator ekonomik që do të jetë në gjendje të kryejë siç duhet servisimin dhe mirëmbajtjen e ashensorëve. Rritja e propozuar e Planit Financiar do të sigurojë mjetet për zbatimin e furnizimit të ri publik dhe lidhjen e kontratës në kohëzgjatje prej një viti. Si arsye për ndërprerjen e marrëveshjes së ndërsjellë, ai deklaroi se, në përputhje me dispozitat ligjore, ashensorët nuk mund të jenë në përdorim nëse nuk ka firmë të autorizuar përgjegjëse për mirëmbajtjen e tyre. Firma e mëparshme u pajtua, deri në zgjedhjen e operatori të ri ekonomik, të mirëmbajë pa pagesë ashensorin e vogël që është në funksion, si dhe platformën. Përndryshe, nëse kontrata do të ndërpritej në mënyrë të njëanshme, do të duhej të nxirrej jashtë përdorimit si ashensori i vogël ashtu edhe platforma, derisa të zgjidhej firmë e re për t'i mirëmbajtur.

Udhëheqësi i Sektorit për financa dhe logjistikë, Goran Radunović, shpjegoi se propozohet të rritet Plani Financiar për 1.710.000,00 denarë dhe furnizimi në përgjithësi do të arrijë në 2 milionë denarë pa TVSH, përkatësisht 2.360.000,00 denarë duke përfshirë TVSH-në. Ai shpjegoi se do të rriten dy pozicione, përkatësisht: niveli i të ardhurave "Mjete të tepërta të transferuara nga vitet e kaluara" rritet për 1.230.000,00 denarë dhe në vend të shumës aktuale prej 71.650.345,00 denarë, do të arrijë në 72.880.345,00 denarë. Gjithashtu do të rritet niveli i të ardhurave "Të ardhura të planifikuara nga mbikëqyrja e ritransmetimit të shërbimeve programore të operatorëve të rrjeteve publike të komunikimit elektronik dhe ofruesve të shërbimeve mediatike audiovizuale me kërkesë" për 480.000,00 denarë dhe në vend të shumës aktuale prej 10.700.000,00 denarë, do të arrijë në 11.180.000,00 denarë. Ai shpjegoi se për këtë qëllim dukshëm janë parashikuar më shumë mjete në krahasim me vitet e kaluara. Ai theksoi se pret që mjetet të mos shfrytëzohen plotësisht, por se është më mirë paraprakisht të planifikohen, me qëllim që mos të kryhet ribalans i Planit Financiar nëse paraqitet nevoja për ndërhyrje shtesë. Ai theksoi se kjo do të mundësojë veprimin në kohë dhe të përshtatshëm nëse nevojiten ndërhyrje shtesë, me qëllim që të tre ashensorët dhe platforma të vihen në funksion dhe të mirëmbahen.

Anëtari i këshillit Viktor Pavlovski theksoi se ashensorët gjithashtu shfrytëzohen dhe nga Ministria e Sportit dhe pyeti nëse shpenzimet do të shpërndahen në mënyrë të përshtatshme midis dy institucioneve.

Udhëheqësi i Sektorit për financa dhe logjistikë, Goran Radunović, shpjegoi se Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale është bartës i furnizimit publik, por pas marrjes së faturave, 35% e shumës i rifaturohet Ministrisë së Sportit. Ai theksoi se, nëse shuma totale është 2 milionë e 360 mijë denarë, pjesëmarrja e Ministrisë do të ishte rreth 900 mijë denarë.

Anëtari i Këshillit Viktor Pavlovski, konstatoi se në një rast të tillë Agjencia do të ketë shpenzime në shumë prej 2 milionë denarë, por edhe të ardhura prej rreth 1 milion denarë në bazë të para-faturimit ndaj Ministrisë së Sportit. Në këtë drejtim, pyeti nëse ishte e nevojshme të ndryshohet Plani Financiar.

Udhëheqësi i Sektorit për financa dhe logjistikë, Goran Radunović, shpjegoi se për shkak se Agjencia është bartës i furnizimit publik, Planit Financiar duhet të përfshijë mjete financiare në total të nevojshëm për zbatimin e furnizimit.

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi Vendim me të cilin miratohet rritja e Planit Financiar të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele për vitin 2026, nr.05-5610/1 të datës 25.12.2025.

Të ardhurat dhe shpenzimet në total të planifikuara sipas Planit Financiar të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele për vitin 2026, rriten për 1.710.000,00 denarë, përkatësisht arrijnë shumën prej 227.060.345,00 denarë.

Me rritjen e Planit Financiar të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele për vitin 2026, nr.05-5610/1 të datës 25.12.2025 sigurohen mjetet financiare në shumë totale prej 1.710.000,00 denarë, të destinuara për:

- Riparim, servisim dhe mirëmbajtje e ashensorëve dhe platformës, në shumën prej 2.360.000,00 denarë, në vend të 650.000,00 denarëve të mëparshëm.

Sektori për përkrahjen e punës së Drejtorit dhe Këshillit, Vendimin e lartpërmendur ta publikojë në faqen e internetit të Agjencisë.

Pika 3

Të ndryshme

Nuk kishte diskutim nën "Të ndryshme".

**Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuele
Kryetari i Këshillit,
mr. Sasho Stefanovski**

Përktheu: Antoneta Shabani